

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

INDUSTRIË ENERGJITIKE

ID 1.7 *“Gaz natyror aromatik ose GLN, pervec rasteve kur veprimtaria eshte e lidhur me tipin A, ose perzierje e aromave”.*

ID 1.10 *“Furnizim me karburant i makinave ne nje stacion te furnizimit me karburant ne zonat urbane”.*

(sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”)

SUBJEKTI “MEROLLI OIL” SHPK

NIPT K04005080H

ADRESA: Korce Korçe KORÇË Zona kadastrale 8564, Nr.pasurie 6/621.

1. PERSHKRIMI I OPERATORIT

Subjekti **“MEROLLI OIL” Sh.p.k.**, me administrator **Kujtim Merolli**, i regjistruar në QKB me **23/01/2001**, me **NIPT K04005080H**.

Fusha e veprimtarise se operatorit konsiston ne **Tregti karburanti**.

Subjekti do te aplikojte per leje mjedisi Tip B

INDUSTRITË ENERGJITIKE

ID 1.7 *“Gaz natyror aromatik ose GLN, pervec rasteve kur veprimtaria eshte e lidhur me tipin A, ose perzierje e aromave”.*

ID 1.10 *“Furnizim me karburant i makinave ne nje stacion te furnizimit me karburant ne zonat urbane”.*

Referuar shtojces 1 te ligjit 52/2020 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR

2. OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT

-Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:

- Emetimet ne ajer dhe zhurmat;
- Ndikimi ne flore/faune;
- Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve;
- Ndikime social-ekonomike;
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara;
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor;
- Ndikim ne peizazhin e zones;

-Objektivi i dyte i ketij aktiviteti eshte gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

3. VENDNDODHJA DHE KARAKTERISTIKAT FIZIKE TE PROJEKTIT:

Operatori "Merolli Oil" Sh.p.k, do te zhvilloje aktivitetin ne adresen **Korce Korçe KORÇË Zona kadastrale 8564, Nr.pasurie 6/621.**

Zona e perzgjedhur per ushtrimin e ketij aktiviteti eshte e pershtatshme per kete lloj aktiviteti duke para parasysh perparsite si:

- Furnizimi me uje;
- Furnizimi me energji elektrike
- Lehtesi ne aksesim nga automjetet (cisternat, automjetet qe furnizohen, zjarrefikeset dhe ambulancat)



PERMBLEDHJE JOTEKNIKE
NIPT K04005080H

Për pronën në të cilën do të zhvillojë aktivitetin, operatori posëdon çertifikatë pronësie, me të dhënat si më poshtë:

Zyra e Regjistrimit	Korçë
Zona Kadastrale	8564
Numër pasurie	6/621
Sipërfaqe totale	670 m²
Truall	670 m²
Ndërtesë	190.14 m²
Adresa e pasurisë	Korçë, Korçë.
Pronësia	MEROLLI OIL



Nr.	X	Y
1.	4481045.48	4497452.39
2.	4481063.59	4497452.29
3.	4481070.57	4497461.10
4.	4481082.36	4497451.64
5.	4481076.03	4497442.49
6.	4481080.26	4497423.77

4. PROCESI TEKNOLOGJIK I AKTIVITETIT

Territori qe do te perdoret per funksionimin e instalimit, me vendndodhje **Korce Korçe KORÇË Zona kadastrale 8564, Nr.pasurie 6/621.**

Operatori do te kryeje furnizimin e mjeteve me lende djegese (Gazoil, Benzine dhe GLN) me pakice. Pozicioni i distributorit, distanca me aksin e rruges eshte projektuar qe te plotesoje kerkesat e Rregullores se Shfrytezimit dhe te Rregullores se Qarkullimit.

Ne piken e karburantit ekzistojne te gjitha paisjet e mbrojtjes nga zjarri dhe punonjesit jane te instruktuar konform legjislacionit per kete qellim.

FOTO TE AKTIVITETIT



Depozita Gazoil, Benzine, GLN

Depozitat jane te testuara nga subjekt i licensuar per te kontrolluar gjendjen mekanike te tyre dhe papershkueshmerine.

Rezervuarët e karburantit janë të paisur me kapak (bakaport). Në kapakun e bakaportës dalin linjat e hyrjes dhe të daljes, shkarkuesja e avujve, matësi i nivelit, kampion marësi.

Rezervuarët janë të lyer nga jashtë me material antikoroziv dhe të veshur me material hidroizolues për tu mbrojtur nga korozioni nëntokësor.

Distributoret e karburantit (Pompat)

Ne pjesen e sipërme janë të mbuluara me një tendë metalike, e cila është mbështetur në kollona prej çeliku mbi zonën e shërbimit. Pompat janë të palevizshme. Veshjet e tyre janë me materiale të cilat i rezistojnë zjarrit. Pompa lidhet me rezervuarin e nëndheshëm dhe me ane të komandave elektronike, në momentin që mjeti vjen për tu furnizuar, terhiqet me ane të një pompe të inkorporuar sasia e hidrokarburit që dëshirohet.

Furnizimi

Furnizimi i çisternes do të bëhet me autobote të specializuara për këtë qëllim, të cilat e shkarkojnë lengun nëpërmjet kapakut me ane të një tubi fleksibel drejt e në çisterne. Ky lloj furnizimi nuk krijon rrjedhje të karburanteve në mjedisin përreth duke vepruar në këtë mënyrë, shkarkimi i karburanteve nga autoboti në depozite bëhet me një sistem të mbyllur dhe që do të kontrollohet gjatë gjithë kohës së shkarkimit në mënyrë të kujdesshme, për të mos lejuar shkarkimin e karburanteve në tokë.

Fuqia Punetore

Në pikën e karburantit janë të punësuar 8 persona.

Subjekti ka pajisur të gjithë punonjësit me uniforme pune dhe me mjete mbrojtëse.


Punonjësit janë të trajnuar dhe zbatojnë rregullat e sigurimit teknik në punë, MNZ si dhe mbrojtjen e mjedisit në ambientet e punës dhe atij përreth.

Shitja e karburanteve

Shitja e karburanteve realizohet me ane të distributorit me pompe dhe pistolette. Zgjedhja e distributorit është bërë sipas kërkesave bashkëkohore që sigurojnë dhënie konstante të sasise, regjistrimin përkatës dhe sigurinë në punë.

4.1. MENAXHIMI I INSTALIMIT

Struktura organizative



KUSHTET E PUNËS					
Numri total i punonjësve	8				
Shpërndarja e punonjësve	ZYRA	PRODHIMI	MIRËMBAJTJA	MAGAZINIMI	TË TJERA
	2	5	1	-	-
Turnet dhe aktivitetet	Zyrat / administrata		Instalimet		
	8⁰⁰-16⁰⁰		6⁰⁰-14⁰⁰ Turni i parë 14⁰⁰ – 22⁰⁰ Turni i dytë 10⁰⁰ – 6⁰⁰ Turni i tretë		
Orët e punës	Zyrat / administrata		Instalimet		
	8 ore/ditë		8 ore/ditë		
Numri i ditëve të punës në vit	365 ditë				
Numri i orëve në vit	8760 orë				
Variacionet sezonale	Ky aktivitetet nuk preket nga variacione sezonale				
Turnet dhe numri i punëtorëve për turn	Gjatë variacioneve sezonale		Pjesa tjetër e vitit		
	Nuk ka variacione sezonale		6⁰⁰-14⁰⁰ Turni i parë 2 punonjes 14⁰⁰ – 22⁰⁰ Turni i dytë 2 punonjes 10⁰⁰ – 6⁰⁰ Turni i tretë 1 punonjes		
Periudhat gjatë të cilave kompania mbyllet	Pushimet		Duke qene nje aktivitet, i cili zhvillohet ne 365 ditet e vitit, punonjesit zevendesohen me njeri-tjetrin ne rast pushimesh.		
	Ndërprerje të rregullta të funksionimit		Ky aktivitet nuk preket nga nderprerje te rregullta te funksionimit		

4.2. LËNDËT E PARA DHE NDIHMËSE

Duke qene se instalimi ne fjale nuk i perket aktivitetit te prodhimit, si rrjedhim nuk ka perdorim te lendeve te para por, ka vetem furnizim te pikes me karburant dhe tregetim te tyre.

Lende te para (per shitje) → Gazoil, Benzine, GLN.

Lende ndihmese → Uje, Energji.

1. Gazoil, Benzine, GLN - *Burimi*: autobote te specializuara per kete qellim.
Sasia: ne varesi te kerkesave te klienteve.
2. Uji do te merret nga rrjeti, sepse do te perdoret vetem per perdorimin e stafit, gjithashtu edhe shkarkimi nga nyjet sanitare do te kryhet ne rrjeti.
3. Energjia elektrike qe do te perdoret vetem per ndricimin e jashtem dhe te brendshem te objektit. Energjia elektrike do te merret nga rrjeti i zones ne baze te kontrates qe operatori ka lidhur me OSHE.

Kushtet e magazinimit te lendes se pare;

1. Rezervuaret duhet te jene te pajisur me certifikate cilesie, qe siguron nje pune pa rreziqe sipas kerkesave te rregulloreve ne fuqi.
2. Cdo punim duhet te kryhet duke respektuar normat dhe standardet e percaktuara nga Komuniteti European.

5. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

VIBRACIONET
Do te gjenerohen vibracione vetem gjate kohes qe Botet do te mbushin depozitat me karburant, si dhe gjate kohes qe mjetet e tonazhit te rende do te furnizohen me lende djegese. Vlen te theksohet se keto vibracione do te jene ne periudhe kohore te shkurter. Pra nuk perben shqetesim per banoret, te cilet banojne ne afersi te instalimit.
RREZATIMI JONIZUES
Nga zhvillimi i aktivitetit nuk ka rrezatime jonizuese.
NDIKIMET NE POPULLESI
Realizimi i projektit nuk do te kete ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullsisë se rajonit ku do zbatohet projekti. Gjate funksionimit te impiantit nuk ka emetime ne ajer, toke apo uje te cilat ndotin ambientin dhe te rrezikojne shendetin e punonjesve apo te popullsisë se rajonit.
NDIKIMET NE AJER
Referuar natyres se aktivitetit mund te kemi kemi ndikime minimale negative ne ajer. Clirime minimale ne ajer, mund te kemi vetem ne momentin e ndjezjes se mjeteve pas furnizimit me karburant, dhe te boteve te cilet furnizojne depozitat me lende djegese. Megjithate ne pikepamjen mjedisore dhe shendetesore keto ndikime mund te konsiderohen te paperfillshme.
NDIKIMET NE TOKE

Zhvillimi i ketij aktiviteti, nuk shoqerohet me shkarkime ne toke. Siperfaqja ne te cilen ushtrohet aktiviteti eshte e shtruar me beton, gje e cila nuk lejon kontaminimin e tokes.

Depozitat jane te testuara nga subjekt i licensuar per te kontrolluar gjendjen mekanike te tyre dhe papershkueshmerine.

Furnizimi i çisternes do te behet me autobote te specializuara per kete qellim, te cilat e shkarkojne lengun nepermjet kapakut me ane te nje tubi fleksibel drejt e ne çisterne. Ky lloj furnizimi nuk krijon rrjedhje te karburanteve ne mjedisin perreth duke vepruar ne kete menyre, shkarkimi i karburanteve nga autoboti ne depozite behet me nje sistem te mbyllur dhe qe do te kontrollohet gjate gjithë kohes se shkarkimit ne menyre te kujdesshme, per te mos lejuar shkarkimin e karburanteve ne toke.

MBETJET

Mbetjet e ngurta urbane qe dalin si rezultat i aktivitetit te punonjesve do te grumbullohen ne vendet e caktuara nga shoqeria dhe me pas do te dergohen per ne vendet e caktuara nga pushteti vendor. Kompania do te punoje per ndarjen e tyre qe ne vendburim, nepermjet konteniereve me ngjyra.

- **Mbetjet e rrezikshme me kod 13 05 02*** ne momentin qe do te arrihet nje sasi e konsiderueshme e tyre, atehere do te njoftohet operator i licensuar (me te cilet subjekti do te lidhe kontrate), qe te kryeje terheqjen e tyre e me pas te kryeje trajtimin/asgjesimin e metejshem te tyre.

NDIKIMET NE UJERA

Funksionimi i aktivitetit nuk do te kete ndikime ne ujera. Ne ujera do te kemi vetem shkarkimin nga nyjet sanitare ne rrjetin e zones. Ujra te gjeneruara nga larja e aktivitetit nuk do te kemi.

NDIKIMET NE KLIME

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasive e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

NDIKIMET NE FLOREN DHE FAUNEN

Zona në të cilën ushtrohet aktiviteti është një zonë pa elemente të spikatur të floras dhe faunes. Kështu që zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ndikon në të. Operatori do të shtojë sipërfaqet e gjelberta për një pamje vizuale më të kënaqshme për syrin dhe për të mirat në pikepamjen mjedisore.

NDIKIMET NGA ZHURMAT

Vendi ku zhvillohet aktiviteti është në afërsi të një rruge ku levizja e mjeteve është gjatë gjithë kohës prezente. Nga funksionimi i këtij aktiviteti nuk pritet të ketë rritje të nivelit zhurmave.

NDIKIMET E AKTIVITETIT TE ZHVILLIMIT MBI NDERTIMET, TRASHEGIMINE ARKITEKTONIKE HISTORIKE DHE ZONAT E MBROJTURA

Aktiviteti që ushtron shoqëria zbatohet në një zonë në sipërfaqen e së cilës dhe në nëntokën e saj nuk ka ndertime lidhur me trashëgimie arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra të tjera njerezore. Kjo tregon që zona është zonë e lirë jo vetëm për të realizuar këto aktivitete.

NDIKIME NE RRJETIN HIDROGRAFIK

Natyra e aktivitetit nuk kërkon përdorim të ujit. Përdorimi i ujit që do të përdoret për njëjtë sanitare do të merret nga rrjeti dhe do të shkarkohet po në rrjetin e zonës për tu menaxhuar me pas nga Ujesjelles Kanalizime të zonës.

NDIKIMET E AKTIVITETIT TE ZHVILLIMIT NE RRUGET LOKALE DHE TRANSPORTIN

Infrastruktura në të gjithë perimetrin e aktivitetit është e shtruar gjithashtu edhe rruga kryesore që kalon pranë aktivitetit. Nuk pritet që të ketë ndikime negative apo ndryshime të infrastruktures.

NDIKIMI SOCIAL-EKONOMIK

Më operimin e këtij aktiviteti pritet të ketë një impakt pozitiv në ekonomine e vendit, në aspektin e punësimit.

Analizat S.W.O.T

Forcat

Dobesite

<ul style="list-style-type: none"> ➤ Potencial për zhvillimin ekonomik. ➤ Rritje e punësimit. ➤ Duke qene nje nder te paktet stacione furnizimi me karburant ne zonen ku operon, ai ka kapacitet per plotesimin e nevojave te tregut. ➤ Eksperienca për një kohë të gjatë në tregëtimin me pakicë te karburanteve. ➤ Operon me çmime konkurruese. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mungesa e politikave per perkrahjen e subjektit. ➤ Evazioni fiskal ne konkurrencen e pa ndershme nga kompani te ndryshme. ➤ Përfitimi i tij ekonomik është subjekt i luhatjeve, duke qenë se kostoja e karburantit ndryshon çdo ditë.
Mundesite	Kercenimet
<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mundesi perfitimi ekonomike nga shitja. ➤ Mundesi punesimi per banoret e zones. ➤ Ofrimi i produkteve cilesore, me cmime te konkrueshem ne tregun vendas. ➤ Maksimizimi i fitimit. ➤ Krijimi i lokacioneve shtesë është gjithmonë një opzion për zgjerimin e stacionit të karburantit. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rënia ekonomike; (Kur ekonomia pëson rënie, ajo ndikon në shpenzimet e konsumatorëve, e cila nga ana tjetër ndikon negativisht në biznes). ➤ Shfaqja e një stacioni të ri karburanti ne afersi të njëjtit vend ku ndodhet ky karburant. ➤ Konkurenca e pa ndershme dhe mos respektimi i detyrimeve dhe percaktimeve ligjore nga subjektet. ➤ Dukurite natyrore, te tilla si: stuhi, permbytje, zjarr, etj.

6. MASAT PËR MINIMIZIMIN E NDIKIMEVE

Mjedisi i ndikuar	Ndikimi	Masat zbutese dhe rekomandime
Toke	Ndikim ne ndotje te tokes	Aktiviteti te kryhet brenda koordinatave te percaktuara. Materialet te jene te standarteve bashkekohore. Si pasoje e emisioneve te mundshme karburante qe mund te emetohen ne menyre aksidentale nga mjetet e transportit, keshillohet te merren masa emergjente pastrimi.
Uje	Ndotje e ujerave siperfaqesore dhe ne ujera nentokesore	Nuk ka ndotje te ujerave nga ushtrimi i ketij aktiviteti. Ujerat sanitarë te shkarkohen ne kanalizimet e zones.

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE
NIPT K04005080H

Ajer	Emisione gazesh	Monitorim i vazhdueshem i gazeve, te cilat vlen te theksohet se do te jene ne vlera te uleta.
	Zhurme, vibrime	Zhurma ne kete subjekt do te kete vetem gjate furnizimit te makinave me karburant dhe gjate procesit te furnizimit te rezervuareve me karburant nga autobotet perkatese. Aktiviteti nuk do te shoqerohet me nivel te larte te zhurmes. Propozohet qe gjate kohes qe mjetet do te furnizohen me lende djegese, te jene kategorikisht te fikura.
Mjedisi biologjik	Flora dhe fauna	Flora dhe fauna e zones nuk do te ndikohet nga aktiviteti i karburantit, pasi zona ku do te zhvillohet aktiviteti eshte zone e varfer ne lloje bimore dhe shtazore.
Mbetjet	Menaxhimi I mbetjeve	<i>Mbetje urbane nga aktiviteti i punonjesve:</i> Mbetjet qe gjenerohen nga aktiviteti do te jene mbetje te perziera urbane qe dalin nga aktiviteti i punonjesve. Mbetjet e perziera urbane do te grumbullohen dhe me pas do te dergohen ne vendet e percaktuara nga Njesia Vendore. Mbetjet e rrezikshme me kod 13 05 02* ne momentin qe do te arrihet nje sasi e konsiderueshme e tyre, atehere do te njoftohet operator i licensuar (me te cilet subjekti do te lidhe kontrate), qe te kryeje terheqjen e tyre e me pas te kryeje trajtimin/asgjesimin e metejsheem te tyre.
Mjedisi human	Shqetesim te banoreve te zones dhe subjekteve perreth	Subjekti ndodhet ne afersi te rruges ne nje hapesire ku kalojne vazhdimisht makina, duke mos sjelle ndikime negative mbi popullsine qe jeton ne afersi te zones.
Ndikime te tjera	Siguria dhe ndikime ne shendet	Me qellim per te siguruar nje nderhyrje te shpejte ne rast zjarri, subjekti do te marre masa per te vendosur fikese zjarri. Realizim i takimeve me stafin per te perballuar situata emergjente dhe vendosjen e posterave sensibilizues dhe njoftues. Punonjesit para se te

		punesohen i nenshtrohen nje vizite mjekesore dhe me pas pajisen me nje libreze shendetesore, e cila leshohet nga Drejtoria e Shendetit Publik.
--	--	--

7. MONITORIMI I PLANIFIKUAR

Qellimi i monitorimit mjedisor:

Te siguroje te dhena nepermjet te cilave te vleresohet nese zhvillimi i veprimtarise eshte ne perputhje me ligjet dhe standartet mjedisore qe lidhen me te, per te vleresuar shkallen e ndikimit (nese ka), si dhe per te vleresuar performancen mjedisore te menaxhimit te saj ne kuader te permiresimit te vazhdueshem.

Objektivat e monitorimit:

- Te krahasoje cilesine dhe gjendjen e mjedisit para fillimit te aktivitetit me ate gjate funksionimit te instalimeve.
- Te monitoroje emetimet (nese ka) ne te gjitha fazat e zhvillimit te projektit, ne perputhje me normat dhe standartet ligjore te Shqiperise ne BE.
- Te percaktoje nese ndryshimet e mundshme mjedisore jane si rezultat i zhvillimeve te aktiviteteteve qe kryhen ne rajonin ku ndodhet objekti ku kryhet funksionimi dhe nese ka lidhje me impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Per te percaktuar efektivitetin e masave permiresuese te zbatuara nga aktoret zhvillues te aktivitetit ne rajon.
- Per te percaktuar impaktet afatgjata (nese ka).
- Per te percaktuar zgjatjen e kthimit ne normalitet te cilesise se mjedisit ne rajon, ne rastet kur vleresohet se ka ndikime dhe impakte ne te.
- Te krijojte nje arkive (regjister) te cilesise se mjedisit, nje baze te dhenash qe do te mund te perdoret ne te ardhmen.
- Per te garantuar pershtatshmerine e nje objekti mjedisore per te perdorur per qellim te caktuar.

Plani i monitorimit do te konsistoje ne:

- Monitorimi i parametrave mjedisore (ajer dhe zhurme).
- Monitorimi i zones se mundeshme te perhapjes se pluhurit.

- Monitorimi i parametrave fizike dhe dinamike te shperndarjes se pluhurit dhe marrja e masave perkatese te parashikuara ne projekt, per parandalimin e tij.
- Monitorimi i sjelljes se bimesise ne zonen perreth objektit dhe marrja e masave per parandalimin e demtimit te tyre.
- Monitorimi i trajnimeve te stafit per rastet emergjente.

MONITORIM I PLANIFIKUAR	PERIUDHA
Monitorim i parametrave mjedisore (ajer dhe zhurme)	Cdo 6 Muaj
Sasia e mbetjeve te gjeneruara dhe transferuara	Ne varesi te punes
Monitorim i gjendjes mekanike te pajisjeve operuese	Cdo dite nga punonjesit e impiantit Cdo 1-2 muaj nga mekanike te posacem
Monitorim i trajnimeve te stafit ne raste emergjente	Cdo 6 muaj – 1 vit
Monitorim i perdorimit eficient te energjise dhe ujit	Cdo vit nga kompania Cdo 2 vjet nga Audituesi i Energjise

“Merolli Oil” Sh.p.k.

Administrator

Kujtim Merolli